



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1217/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1217/2021 të datës 24.12.2021 të parashtruar nga ankuesi Ibër Alaj me adresë Rruga "Nazim Gafurri", VI/28, Nr.3-1, Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "*masës disiplinore-largim nga Shërbimi Civil*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe nenin 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 21.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

**I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.1217/2021 e datës 24.12.2021 e parashtruar nga ankuesi Ibër Alaj.

**II. NDRYSHOHET** Vendimi me KD Nr.07/2021 i datës 06.12.2021 i Komisionit Disiplinori Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit lidhur me masën disiplinore ndaj ankuesit, ashtu që masa disiplinore "*Largohet nga Shërbimi Civil në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*", zëvendësohet me masën disiplinore "*Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për tre (3) vjet*".

**III. OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke ndryshuar masën disiplinore "*Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për tre (3) vjet*", gjithashtu të bëhet kompensimi i pagës nga dita e pezullimit deri në ditën e zbatimit të këtij vendimi.

**IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit Ibër Alaj i punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, sipas Akt emërimit me numër 228/2014 të datës 29.01.2014 në pozitën "Drejtor i Departamentit" Departamenti i Sportit, më datë 05.11.2021 Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit parashtron kërkesë me numër të





referencës 4204/2021 për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit Ibër Alaj tek Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore dhe Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 06.12.2021 nxjerr Vendim me numër KD NR.07/2021 me të cilin vendim ankuesit Ibër Alaj, i shqipton masën disiplinore *"Largim nga Shërbimi Civil i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit"*.

Ankuesi Ibër Alaj, i pa kënaqur me Vendimin me numër KD Nr.07/2021 të datës 06.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 24.12.2021 parashtron ankesë me numër të protokollit 6327/21 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 04.02.2022 merr vendimin VK.nr.12/2022 për vazhdim të afatit për vendimmarje edhe për dhjetë (10) ditë pune lidhur me ankesën e ankuesit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.01.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa Këshilli më datë 24.01.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/3000.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Vendimi VKnr.12/2022 i datës 04.02.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 20.07.2020 me numër 92/2020 i Ministres së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ankesa e ankuesit e datës 24.12.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për iniciim të procedurës disiplinore e datës 05.11.2021; Vendimi i datës 06.12.2021 i Komisionit Disiplinor; Përgjigja për Ri-Licencim e datës 20.04.2016 me numër të referencës 428/2016; Raporti nga kuvendi zgjedhor i Federatës së Tekwandos e datës 13.05.2015 me nr.ref.358/2016; Rekomandimi për Ri-Licencim i datës 20.06.2016 me nr.ref.708/2016; Kërkesa për trajtim të Ri-licencimit Federata e Taekwondos të Kosovës kërkuar nga Kabineti i Ministrit; Përgjigja në kërkesën e tuaj për sigurimin e dokumenteve e datës 08.08.2017 me nr.ref.3542/2017; Opinioni lidhur me kërkesën e datës 26.07.2016 për shqyrtim të licencimit të FTK-së; Kërkesa për kthim të ligjshmërisë në MKRS e datës 05.11.2021 me nr.ref.4199/2021; Aktvendim për papranueshmëri në rastin Nr.KI37/19 i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Memorandum bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Federata e Triathlonit e Kosovës; Akt emërimi i datës 29.01.2014 me nr.228/2014; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 26.03.2013; Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Brendshëm të MKR-së e datës 23.06.2010; Vendim i datës 27.08.2021 për formimin e Komisionit Disiplinor; E-mail i datës 05.11.2021; Njoftimi për iniciimin e procedurës disiplinore i datës 05.11.2021; Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 23.11.2021, 02.12.2021; e-mail i datës 06.12.2021; Vendimi i datës 12.10.2017 me nr.75/2017; Shkresa konfirmim i datës 26.04.2018 me nr.ref.454/2018; Rekomandim për Licencimin e Federatës së Taekwondos e datës 11.04.2021 me nr.ref.434/2018; Vendim i datës 10.04.2018 me nr.ref 426/2018; Aktgjykimi me A.nr.870/2016 i datës 01.03.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigje në kërkesën e datës 11.01.2018 me nr.ref. 28/2018; Përmbyllja e subvencioneve periudha TMI-2019 datë 19.07.2019; Raporti i punës për vitin 2018 dhe projektbuxheti për vitin 2019 i datës 02.09.2019 me nr.ref.373/2019; e-mail i datës 22.11.2021; Vendim Ref 06-7765/2017; Vendim Nr.KSH-OJQ/17-2017 i datës 27.11.2017; Aktgjykimi AA.nr.162/2018 i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Parashtrësia ndaj ftesës përmes postës elektronike të Komisionit Disiplinor të MKRS-së e datës 25.11.2021; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës,



Rinisë dhe Sporti dhe Komunës së Pejës e datës 13.01.2016 me nr.ref.99/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Komunës së Pejës e datës 03.02.2017 me nr.ref.312/2017; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Komunës së Pejës e datës 03.02.2017 me nr.ref.313/2017; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Komunës së Pejës e datës 03.02.2017 me nr.ref.314/2017; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Komunës së Shtimës e datës 08.03.2017 me nr.ref.728/2017; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Komunës së Shtimes e datës 08.03.2017 me nr.ref.729/2017; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës Mundjes të Kosovës e datës 10.03.2016 me nr.ref.886/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës së Skijimit të Kosovës e datës 10.03.2016 me nr.ref.895/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës Karatesë të Kosovës e datës 10.03.2016 me nr.ref.896/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës Sportit Shkollor të Kosovës e datës 10.03.2016 me nr.ref.897/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës Notit të Kosovës e datës 10.03.2016 me nr.ref.898/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës Kik-Boxit të Kosovës e datës 10.03.2016 me nr.ref.899/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës Tenisit të Kosovës e datës 10.03.2016 me nr.ref.900/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës Çiklizmit të Kosovës e datës 10.03.2016 me nr.ref.901/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës e Sportit Shkollor e Republikës së Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1223/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës e Atletikës e Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1224/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës e Xhudos e Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1225/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Notit e Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1226/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës e Tenisit e Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1227/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës e Mundjes e Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1220/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Pingpongut e Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1229/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Boksit e Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1230/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Karatesë të Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1231/2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 14.04.2020 me nr. Ref.1270/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Gjimnastikës e Kosovës e datës 08.04.2020 me nr.ref.1467/2020; Kërkesa zyrtare për shpenzime e datës 14.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata Skitare e Kosovës e datës 08.04.2020 me nr.ref.1465/2020; Kërkesa zyrtare për shpenzime e datës 14.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Triatlonit e Kosovës e datës 02.04.2020 me nr.ref.1464/2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 14.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Badmintonit të Kosovës e datës 08.04.2020 me nr.ref.1461/2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 14.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Sportit Shkollor e Republikës së Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1223/2020; Kërkesa zyrtare e shpenzimeve e datës 14.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Atletikës e Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1224/2020; Kërkesa



zyrtare për shpenzime e datës 14.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Notit e Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1226/2020; Kërkesa zyrtare e shpenzimeve e datës 14.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Xhudos e Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1225/2020; Kërkesa zyrtare e shpenzimeve e datës 14.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Tenisit e Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1227/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës së Volejbollit të Kosovës e datës 13.04.2017 me nr.ref.1354/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Basketbollit të Kosovës e datës 13.04.2017 me nr.ref.1355/2017; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës së Atletikës të Kosovës e datës 13.04.2017 me nr.ref.1356/2017; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës së Xhudos të Kosovës e datës 13.04.2017 me nr.ref.1357/2017; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës së Karatesë të Kosovës e datës 13.04.2017 me nr.ref.1358/2017; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe e datës 22.04.2020 me nr.ref.1359/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Trajnerit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1360/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportit : datës 22.04.2020 me nr.ref.1361/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1362/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1363/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistes e datës 22.04.2020 me nr.ref.1364/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistes e datës 22.04.2020 me nr.ref.1365/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1366/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistit Kushtrim Bajraktari e datës 22.04.2020 me nr.ref.1367/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistes e datës 22.04.2020 me nr.ref.1368/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistes e datës 22.04.2020 me nr.ref.1369/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistes e datës 22.04.2020 me nr.ref.1371/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Trajnerit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1372/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1373/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistes e datës 22.04.2020 me nr.ref.1374/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistes e datës 22.04.2020 me nr.ref.1375/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1376/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1377/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistes e datës 22.04.2020 me nr.ref.1378/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Trajnerit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1379/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1380/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Trajnerit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1381/2020; Memorandum Bashkëpunimi i



lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1382/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Trajnerës e datës 22.04.2020 me nr.ref.1383/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Trajneres e datës 22.04.2020 me nr.ref.1384/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistes e datës 22.04.2020 me nr.ref.1385/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Trajnerit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1387/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Trajnerit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1388/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1389/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1390/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Trajnerit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1391/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Trajnerit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1392/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1394/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1395/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1396/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Sportistes e datës 22.04.2020 me nr.ref.1397/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Trajnerit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1398/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Trajnerit e datës 22.04.2020 me nr.ref.1399/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Boulingut e Kosovës e datës 22.04.2020 me nr.ref.1410/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Body-Buildingut dhe Fitnesit e Kosovës e datës 23.04.2020 me nr.ref.1411/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Autosporteve e Kosovës e datës 23.04.2020 me nr.ref.1412/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata Sportive e Punëtorëve të Kosovës e datës 23.04.2020 me nr.ref.1413/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Peshëngritjes e Kosovës e datës 23.04.2020 me nr.ref.1414/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Muay Thai e Kosovës e datës 23.04.2020 me nr.ref.1415/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Minigolfit e Kosovës e datës 23.04.2020 me nr.ref.1416/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Kick-Box-it e Kosovës e datës 23.04.2020 me nr.ref.1417/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Aeronautike e Kosovës e datës 23.04.2020 me nr.ref.1418/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Sporteve Universitare e Kosovës e datës 23.04.2020 me nr.ref.1419/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata Sporteve për të Verbër e Kosovës e datës 24.04.2020 me nr.ref.1431/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata Sporteve për të Verbër e Kosovës e datës 24.04.2020 me nr.ref.1431/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Komitetit Paraolimpik të Kosovës e datës 24.04.2020 me nr.ref.1432/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Bilardos e



Kosovës e datës 24.04.2020 me nr.ref.1433/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Federata e Bjeshkatarëve Alpiniste e datës 24.04.2020 me nr.ref.1434/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Organizata e Tifozerisë Kombëtare Dardanët e datës 24.04.2020 me nr.ref.1435/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Skenderajt e datës 25.04.2020 me nr.ref.1578/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Skenderajt e datës 25.04.2020 me nr.ref.1579/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Prizrenit e datës 22.05.2020 me nr.ref.1648/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Gjakovës e datës 22.05.2020 me nr.ref.1649/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Gjilanit e datës 27.05.2020 me nr.ref.2522/2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Vushtrrisë e datës 22.06.2016 me nr.ref.2951/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Pejës e datës 18.07.2016 me nr.ref.3309/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Kaçanikut e datës 19.07.2016 me nr.ref.3314/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Suharekës e datës 20.07.2016 me nr.ref.3330/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Gjilanit e datës 26.07.2017 me nr.ref.3369/2017; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Gjilanit e datës 26.07.2017 me nr.ref.3370/2017; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Gjilanit e datës 26.07.2017 me nr.ref.3371/2017; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Malishevës e datës 27.07.2016 me nr.ref.3405/2016; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Ferizajt e datës 18.08.2016 me nr.ref.3757/2016; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 14.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Federata Shenjëtarisë e Kosovës e datës 08.04.2020 me nr.ref.1462/2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 14.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Federata e Çiklizmit e Kosovës e datës 08.04.2020 me nr.ref.1466/2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 14.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Federata e Shigjetarisë e Kosovës e datës 08.04.2020 me nr.ref.1468/2020; Parashtresa e ankuesit e datës 02.12.2021 me numër 4751/2021; Letërkonfirmim i datës 10.01.2019 Ref.06-04/2019; Vendimi Ref.06-200/2018; Vendimi i datës 05.11.2021 KD.Nr.06/2021 nga Komisioni Disiplinor; Urdhër Obligimi për Pagesë i datës 10.01.2020; Marrëveshja për pagesë të avancit i datës 09.12.2019; Kërkesa zyrtare për shpenzime e datës 25.11.2019; Vendimi i datës 10.01.2010; Vendimi i datës 27.11.2019; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Federata e Basketbollit e Kosovës e datës 26.03.2019 me nr.ref.1101/2019; Planifikimi i buxhetit për vitin 2019; Urdhër Obligimi për Pagesë i datës 17.01.2020; Marrëveshja për pagesë të avancit i datës 10.01.2020; Vendimi i datës 16.01.2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 25.11.2019; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Federata e Mundjes e Kosovës e datës 05.03.2019 me nr.ref.711/2019; Kalendari i garave për vitin 2019; Urdhër Obligimi për Pagesë i datës 11.03.2020; Marrëveshja për pagesë të avancit e datës 06.03.2020; Vendimi i datës 05.03.2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 03.03.2020; Formulari për vlerësimin e projektit nr.i projektit 01/2020; Kërkesë nga federate e Skitare e Kosovës e datës 02.01.2020; Pro fatura e datës 29.01.2020; Kontratë për ndarjen e mjeteve financiare e datës 05.03.2020; Urdhër Obligimi për pagesë i datës 10.04.2020; Marrëveshja për pagesë të avancit e datës 10.04.2020; Vendim i datës 07.04.2020; kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 07.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Federata e Basketbollit e Kosovës e datës 06.04.2020 me nr.ref.1223/2020; Urdhër Obligimi për Pagesë e datës



24.04.2020; Marrëveshje për pagesë të avancit e datës 24.04.2020; Marrëveshje për pagesë të avancit e datës 21.04.2020; Vendimi i datës 07.04.2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 07.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Hendbollit e Kosovës e datës 06.04.2020 me nr.ref.1222/2020; Planit financiar për vitin 2020; Urdhër Obligimi për Pagesë e datës 24.04.2020; Marrëveshja për pagesë të avancit e datës 21.04.2020; Vendimi i datës 07.04.2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 07.04.2020; Urdhër Obligimi për Pagesë e datës 27.04.2020; Marrëveshja për pagesë të avancit e datës 21.04.2020; Vendimi i datës 16.04.2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 14.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Xhudos e Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1225/2020; Plan programi i punës i Federatës së Xhudos e Kosovës për periudhë Janar-Dhjetor 2020; Kalendari i FXHK-së 2020; Urdhër Obligimi për Pagesë e datës 20.03.2020; Marrëveshja për Pagesë të Avancit e datës 19.03.2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 18.02.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Notit e Kosovës e datës 05.03.2019 me nr.ref.712/2019; Kalendari 2019; Urdhër Obligimi për Pagesë e datës 08.05.2020; Marrëveshja për pagesë të avancit e datës 22.04.2020; Vendimi i datës 07.04.2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 07.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Komiteti Olimpik i Kosovës e datës 06.04.2020 me nr.ref.1225/2020; Komiteti Olimpik i Kosovës; Urdhër Obligimi për pagesë e datës 06.05.2020; Marrëveshje për pagesë të avancit e datës 22.04.2020; Vendim i datës 07.04.2020; Kërkesë për zyrtare për shpenzime e datës 07.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Volejbollit e Kosovës e datës 06.04.2020 me nr.ref.1726/2020; Kalendari i Garave 2020; Plan programi i punës dhe Financiar 2020; Urdhër Obligim për pagesë e datës 14.07.2020; Marrëveshja për pagesë të avancit e datës 21.04.2020; Vendimi i datës 17.04.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Atletikës e Kosovës e datës 07.04.2020 me nr.ref.1224/2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 14.04.2020; Planit zhvillimor i atletikës 2020; Urdhër Obligimi për Pagesë i datës 16.07.2020; Marrëveshja për pagesë të avancit e datës 19.05.2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 08.05.2020; Vendimi i datës 14.05.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Body-Buildingut dhe Fitnesit e Kosovës e datës 23.04.2020 me nr.ref.1414/2020; Plan-programi i punës dhe Financiar për vitin 2020; Urdhër Obligimi për pagesë e datës 20.07.2020; Marrëveshje për pagesë të avancit e datës 22.06.2020; Vendimi i datës 21.05.2020; Kërkesë për zyrtare për shpenzime i datës 08.05.2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 20.05.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Kick-Box-it e Kosovës e datës 23.04.2020 me nr.ref.1417/2020; Kalendari i Garave për vitin 2020; Urdhër Obligim për Pagesë e datës 17.07.2020; Marrëveshje për pagesë të avancit e datës 10.01.2020; Vendimi i datës 24.12.2019; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 11.12.2019; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Futbollit e Kosovës e datës 17.04.2020; Planit Financiar për vitin 2019 nga Federate e Futbollit e Kosovës e datës 28.06.2019; Urdhër Obligimi për pagesë e datës 24.07.2020; Marrëveshja për pagesë të Avancit-paradhënie e datës 22.07.2020; Vendimi i datës 14.07.2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime e datës 10.07.2020; Formulari për vlerësimin e projektit nr. i projektit 08/0720; Projekt Propozimi i datës 11.03.2020; Urdhër Obligimi për pagesë i datës 06.08.2020; Marrëveshja për pagesë të Avancit i datës 30.07.2020; Vendimi i datës 24.07.2020; Kërkesë zyrtare e shpenzimeve e datës 14.07.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federata e Volejbollit e Kosovës e datës 17.11.2020 me nr.ref.3996/2020; Federata e volejbollit e Kosovës e datës 02.10.2020; Vërtetim e datës 01.10.2020; Urdhër Obligimi për pagesë i datës 30.11.2020; Marrëveshja për pagesë të avancit-paradhënie e datës 24.11.2020; Vendimi i datës 23.11.2020; Memorandum Bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Federatës së Basketbollit të Kosovës e datës 17.11.2020 me nr.ref.3994/2020; Federata e Basketbollit të Kosovës e datës 01.10.2020; Certifikata e Regjistrimit te OJQ-së për Evolution Dance; Certifikata e Numrit Fisakl 60029523; Kërkesë zyrtare për shpenzime datë 21.07.2021; Formulari për



regjistrimin të furnitorit e datës 16.11.2021; Certifikatë e Regjistrimit të OJQ-së Filizat e datës 21.03.2013; Certifikata e Numrit Fiskal 601720990; Vërtetim për klient të PCBK-s; Kontratë për ndarjen e mjeteve financiare e datës 03.11.2021; Formulari për regjistrimin të furnitorit; Vërtetim nga NLB Bank; Certifikata për Regjistrimin e OJQ-së Shoqata Hoteliere Turistike Promovimit dhe Integritetit; Certifikata e Numrit Fiskal 600892518; Kontrata për ndarjen e mjeteve e datës 19.10.2021; Formulari për regjistrimin e furnitorit e datës 17.11.2021; Urdhër obligimi pagesës e datës 10.04.2020; Urdhër blerje e datës 20.03.2020; Vendimi për kompensim financiar i datës 12.03.2020; Kërkesa e datës 11.03.2020; Vendimi i datës 20.06.2018; Vendimi i datës 12.11.2018; Urdhër Obligimi për pagesë i datës 11.03.2020; Marrëveshje për pagesë të avansit i datës 09.03.2020; Vendimi i datës 05.03.2020; Kërkesë zyrtarë për shpenzime e datës 03.03.2020; Formulari për vlerësimin e projektit; Raporti i shpenzimeve/ndihma e fondit emergjent 2020 në Kulturë si dhe përgjigjja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar pjesërisht për shkak të shkeljeve procedurale dhe ligjore të bëra nga organi i punësimit.*

Ankuesi sipas Akt emërimit të datës 29.01.2014 ka qenë në pozitën "Drejtor në Departamentin e Sportit" ndërsa me Vendimin me numër 92/2020 të datës 20.07.2020 është caktuar Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili këtë detyrë e ka ushtruar deri më datë 04.11.2021 kur është shkarkuar me Vendim numër 132/2021 të Ministrit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ndaj ankuesit me datë 05.11.2021 Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit parashtron kërkesë me numër të referencës 4204/2021 për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me detyrë Drjetor i Departamentit të Sportit dhe i caktuar Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit deri më datë 04.11.2021.

Me datë 05.11.2021 Komisioni Disiplinor nxjerr Vendim me numër KD.Nr.06/2021 me të cilin e pezullon ankuesin nga detyra e Drejtorit të Departamentit të Sportit deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtarë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor pas pranimit të kërkesës me numër të protokollit 4204/2021 të datës 05.11.2020 të parashtruar nga Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka shqyrtuar rastin e ankuesit dhe me datë 06.12.2021 ka nxjerr Vendim me numër KD Nr.07/2021 me të cilin vendim ankuesit i shqipton masën disiplinore „Largim nga Shërbimi Civil i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit në ankesën e datës 24.12.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka kundërshtuar Vendimin me KD Nr.07/2021 të datës 07.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të ligjit material.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit për sa i përket kërkesës për fillim të procedurës disiplinore dhe rrjedhimisht duke iu referuar dispozitave ligjore të nenit 48 përkatësisht paragrafit 4 nën paragrafi 4.2 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik, dhe meqenëse në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje të supozuara të Raportit të auditimit të pasqyrave financiare nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i paqëndrueshëm.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar që Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me rastin e inicimit të procedurës disiplinore përmes kërkesës me numër të protokollit 4204/2021 të datës 05.11.2020, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë procedurën disiplinore dhe masat disiplinore për nëpunësit civil sepse me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik përkatësisht në nenin 6 dhe 7 është përcaktuar procedura se si duhet të paraqitet shkelja disiplinore dhe cilat elemente duhet të përmbajë kërkesa për inicim të procedurës disiplinore, ndërsa me dispozitat e nenit 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, janë përcaktuar kompetencat e Komisionit Disiplinor, si në vijim **„Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. „Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura” dhe 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore**, andaj në rastin konkret Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore përveç kualifikimit të shkeljes disiplinore ka kërkuar nga Komisioni Disiplinor që ndaj ankuesit të shqiptohet masa disiplinore *„Largim nga strukturat e shërbimi civil”* si dhe *“pezullimin e përkohshëm të ankuesit deri në momentin e përfundimit të procedurës”*, veprim ky i cili është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi sepse iniciuesi pasi konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndësishme ka kompetencë vetëm ta paraqes rastin me shkrim të udhëheqësi i njësisë së personelit ndërsa Komisioni Disiplinor ka kompetencë të dëgjoj dhe shqyrtoj provat në lidhje me shkeljen e supozuar, të vendos nëse është kryer shkelja e supozuar dhe në bazë të konstatimit të shkeljes së kryer, Komisioni duhet të përcaktojë dhe shqiptojë masën disiplinore për shkeljet e rënda serioze e cila është e përcaktuar me dispozitat e nenit 47 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, andaj Kolegji konstaton se ky veprim i Ministrisë është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në punën e Komisionit dhe ushtrim i ndikimit në vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit ka konstatuar se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.Nr.07/2021 të datës 06.12.2021, ka administruar prova që nga viti 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021 andaj Komisioni Disiplinor me rastin e shqyrtimit të rastit nuk ka marr parasysh faktin se me datë 11.09.2019 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa me datë 25.11.2019, Gjykata Kushtetuese me Vendim Nr. ref.:VVMP 1525/20 për Masë të Përkohshme e ka pezulluar Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe pas vendosjes së masës së përkohshme të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga Gjykata Kushtetuese të gjitha institucionet publike kanë aplikuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil deri më datë 09.07.2020 kur ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, rrjedhimisht Komisioni Disiplinor me rastin e shqyrtimit të lëndës së ankuesit, në bazë kompetencës së vet gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale sepse për shkeljet e supozuara disiplinore të cilat kanë ndodhur në periudhën kohore kur ka qenë në fuqi gjegjësisht i aplikueshëm Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, Komisioni gabimisht për atë periudhë ka aplikuar Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Komisioni Disiplinor gjatë shqyrtimit të çështjes lidhur me shkeljen e supozuar për licencim të Federatës së Taekwondos së Kosovës nuk e ka marrë parasysh faktin konkretisht Aktvendimin me numër të rastit nr.K137/19 të datës 09.01.2020, të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, për Papranueshmëri të kërkesës së parashtruar nga Federata e Taekwondos e Kosovës e cila më këtë aktvendim e ka deklaruar kërkesën e papranueshme të parashtruesit Federata e Taekwondos e Kosovës dhe ka konstatuar se nuk ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe të dispozitave kushtetuese, ndërsa në pikën 79 të arsytimit të aktvendimit Gjykata ka vlerësuar se *“MKRS i ndau licencën parashtruesit të kërkesës në pajtim me vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me të cilin urdhëroj MKRS të nxjerr vendim sipas kërkesës së parashtruesit dhe që ai vendim të jetë i drejtë dhe i bazuar në ligj. Një veprim i tillë i MKRS (shih vendimin e MRKS/Nr.29/2018 të 11 prill 2018) është përmbaaruar në tersi, aktgjykimi i kontestuar me numër A.nr.870/2016 i Gjykatës Themelore”*, andaj Kolegji në bazë të dëshmive të ofruara respektivisht



këtij aktvendimi ka konstatuar se te gjitha veprimet e institucionet kane qene ne pajtim me ligjin dhe se ne këtë rast nuk kemi të bëjmë me shkelje të detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me rastin e nxjerrjes se vendimit me numër KD.Nr. 07/2021 të datës 06.11.2021, me të cilin i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit", ka vepruar në kundërshtim nënin 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se „Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. „Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura” dhe 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore” dhe në kundërshtim me nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se: „Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 4.1. Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 4.2. Shkallën e fajësisë; 4.3. Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit; 4.4. Përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit” sepse në rastin konkret Komisioni nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat dhe faktet, nuk kane marrë për bazë periudhën kohore kur ankuesi i ka kryer këto shkelje, si dhe nuk i ka saktësuar saktë shkeljet e supozuara dhe dëmin material por vetëm ka dhënë formulim të përgjithshëm të rastit rrjedhimisht Komisioni Disiplinor gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale sepse për shkeljet e supozuara disiplinore të cilat kanë ndodhur në periudhën kohore kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, Komisioni gabimisht për atë periudhë ka aplikuar Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, sepse konkretisht me nenin 12 paragrafin 1 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil ka qene e përcaktuar se: “Nëse udhëheqësi i drejtpërdrejtë konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë-serioze, në afat prej dy 2 ditë pune do ta paraqesë rastin me shkrim të udhëheqësi i njësisë së personellit”. rrjedhimisht shkeljet të cilat kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik janë parashkruar sepse kanë qenë të përcaktuara afate tjera të inicimit të procedurës disiplinore kur supozohet se nëpunësi ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës.

Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.Nr.07/2021 të datës 06.12.2021, tek rrethana e dytë sipas kërkesës se iniciuesit që ka të bëjë me të gjeturën sipas raportit të auditimit të pasqyrave financiare nga Zyra Kombëtare e Auditimit, konkretisht me të gjeturën A3 lidhur me parregullësi në menaxhimin e subvencioneve të dhëna për Federatat e Sporteve të Kosovës konkretisht me rastin e vonesave dhe mangësive në mbylljen dhe arsyetimin e subvencioneve nga federatat .... ka konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, 3.7 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 21 të Rregullores Nr.09/2015 për subvencionimin në fushën e kulturës, rinisë dhe sporteve dhe pikës 5.7 të memorandumëve të bashkëpunimit të lidhura ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Federatave të Sporteve të Kosovës, mirëpo nuk ka arritur të konstatoj saktë nëse ankuesi me veprimet e tij ka shkaktuar ndonjë dëm të pariparueshëm për ministrinë.

Gjatë shqyrtimit të të gjitha provave të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të Rregullores Nr.09/2015 për Subvencionimin në Fushën e Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Rinisë dhe Sportit ka konstatuar në bazë të nenit 21 paragrafi 7 dhe 8 çështja e afateve duhet të përcaktohet me kontratë apo me memorandum të bashkëpunimit si dhe duhet të parashikohen procedurat e mëtejshme për rastet e përmbushjes ose përmbushjes së parregullt të detyrimeve nga federatat, ndërsa pas analizimit të Memorandumëve të Bashkëpunimit mes Federatave dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit Kolegji ka konstatuar se federatat afatin për raportim me shkrim me raport narrativ për shpenzimin e mjeteve sipas realizimit të aktiviteteve sportive e kane të përcaktuar me memorandum të bashkëpunimit respektivisht federatat janë të obliguara që çdo tre muaj, të raportojnë me shkrim me raport narrativ për shpenzimin e mjeteve sipas realizimit të aktiviteteve sportive para se Ministria e



Kulturës, Rinisë dhe Sportit, t'ia alokoj mjetet për tre mujorin e radhës. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave po ashtu analizuar edhe te gjeturën A3 nga Zyra Kombëtare e Auditimit me raportin për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2020 që ka te bëjë, me parregullësi në menaxhimin e subvencioneve të dhëna për Federatën e Sporteve të Kosovës e cila e ka theksuar se: *"Sipas memorandumeve të bashkëpunimit të lidhura ndërmjet MKRS dhe federatave të sporteve të Kosovës përkatësisht pika 5.7 specifikon që federata janë të obliguara që të raportojnë për çdo periudhë tremujore për shpenzimin e mjeteve sipas realizimit të aktivitetit sportiv, para se MKRS t'ia alokoj mjetet për tre mujorin e radhës. Tutje rregullorja Nr.09/2015 për subvencionimin në fushën e kulturës, rinisë dhe sporteve përkatësisht nenit 21 pika 1, përcakton se përfituesit e subvencioneve pas realizimit të projekteve janë të obliguar të bëjnë mbylljen e tyre. Ndërsa pika 2.2 specifikon se përfituesit duhet që shpenzimet e mjeteve të përfituara t'ia arsyetojnë me dorëzimin e dëshmiave të dokumentuara"*, rrjedhimisht Kolegji në bazë të fakteve të lartcekura ka konstatuar se ankuesi është dashur që të ndër marrë veprime dhe të kërkojë raport nga zyrtari përkatës monitorues për kryerjen e obligimeve ligjore për shpenzimin e mjeteve sipas realizimit të aktiviteteve sportive nga përfituesit financiar gjegjësisht Federatat ndaj Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, andaj Kolegji konstaton, se ankuesi me veprimet apo mosveprimet e tij ka bërë shkelje të rënda disiplinore lidhur me mosrespektim të afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave të Federatave ndaj Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit sipas nenit 46 paragrafit 3 nën paragrafit 3.2 dhe 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrat e Publikë, gjegjësisht Kolegji ka konstatuar se ka pas mos respektim të afateve lidhur me subvencionet por nuk është shkaktuar dëm i riparueshëm për institucionin dhe palët.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në të gjitha provat e lëndës, si dhe faktin që nuk është shkaktuar dëm material i riparueshëm për institucionin dhe palët nga veprimet e ankuesit, konstaton se masa disiplinore *"Largim nga Shërbimi Civil i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit"*, është masë e rëndë në krahasim me shkeljen, rrjedhimisht masa disiplinore është në kundërshtim me nenin 50 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë, nenin 13 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrat e Publikë, i cili përcakton se: *"Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer"*, kështu që në kuptim të nenit 18 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Kolegjet e Këshillit që shqyrtojnë ankesat, bazuar në paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të këtij neni, kanë të drejtë të ndryshojnë masën disiplinore në rastet kur vërtetohet se nëpunësi civil e ka kryer shkeljen, mirëpo organi i punësimit nuk i ka shqiptuar masën disiplinore në proporcion me shkeljen e kryer"*, atëherë ndryshohet vendimi me KD Nr.07/2021 i datës 06.12.2021 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit lidhur me masën disiplinore ndaj ankuesit, ashtu që masa disiplinore *"Largim nga Shërbimi Civil i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit"*, zëvendësohet me masën disiplinore *"Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për tre (3) vjet."*

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ka mandat ligjor që ta obligoj Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi, duke ndryshuar masën disiplinore në *"Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për tre (3) vjet"*, gjithashtu të bëhet kompensimi i pagës nga dita e pezullimit deri në ditën e zbatimit të këtij vendimi.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i*



*Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”.*

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1217/2021**

Valentina Kaçandoll-Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankesit
- Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.